



Prishtinë, 16 prill 2019
Kodi i ZRRE-së: V_1134_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtritshme të Energjisë;
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve,dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në kulmin e shtëpisë individuale të ndërtuar në parcelën me nr. 1618-26, ZK Prishtinë, me kapacitet të instaluar prej **5 kW** në Komunën e Prishtinës, të datës 02.04.2019 me nr. prot. 214/2019 të aplikuesit Rahman Duli, me adresë: "Matiqan", Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur më 16 prill 2019 nxori këtë:

V E N D I M

PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM

- I. APROVOHET**- kërkesa e aplikuesit Rahman Duli për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në parcelën me nr. 1618-26, ZK Prishtinë, me kapacitet të instaluar prej **5 kW**, mbi kulmin e shtëpisë, Komuna e Prishtinës.
- II. OBLIGOHET** – aplikuesi Rahman Duli me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DPR-90058255 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtrij kërkesë në KEDS SH.A., për pranim teknik të objektit energjetik.
- III.** ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV.** Aplikuesi Rahman Duli do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.

A r s y e t i m



- ZRRE, me datë 02.04.2019 nga aplikuesi Rrahman Duli ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në kulmin e shtëpisë individuale të ndërtuar në parcelën me nr. 1618-26, ZK Prishtinë, me kapacitet të instaluar prej **5 kW**, shifra e konsumatorit DPR-90058255, Komuna e Prishtinës.
- Aplikuesi, s'bashku me aplikacioni ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetorë të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergjetik Nr. 531 të datës 11.02.2019 të lëshuar nga KEDS SH.A., raportin teknik Nr. 1987 të datës 29.03.2019 të lëshuar nga KEDS SH.A., projektin ekzekutues dhe Vendimin Nr. 05-352/10-0248121/18 të datës 15.11.2018 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm e Komunës së Prishtinës.
- Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit Rrahman Duli, dhe dëshmive të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike në kulmin e shtëpisë individuale të ndërtuar në parcelën me Nr. 1618-26, ZK Prishtinë, me kapacitet të instaluar prej **5 kW**, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Prishtinës,
- KEDS SH.A., dhe
- Arkivit të ZRRE-së